EMRI/ Qëlloi me kallashnikov në ajër për të kanosur kushëririn e tij, arrestohet 26-vjeçari në Durrës

22 Gusht, 2023 10:46

Madhësia e tekstit:

Policia e Durrësit ka arrestuar një 26-vjeçar, pasi qëlloi në ajër me kallashnikov për të kanosur kushëririn e tij.

Uniformat blu bëjnë me dije se shkak ka qenë një konflikti për motive të dobëta, ndërsa mësohet se në pranga ka rënë shtetasi Euron Balla, banues në fshatin Jubë të Durrësit.

Njoftimi i policisë:

Durrës/Finalizohet operacioni policor i koduar "Kalibri", sekuestrohen një armë zjarri kallashnikov, 2 krehra dhe 54 fishekë luftarak.

Qëlloi me kallashnikov në ajër, për të kanosur kushëririn e tij, pas një konflikti për motive të dobëta, ndërmjet tyre, arrestohet në flagrancë 26-vjeçari.

Pas marrjes së njoftimit se në fshatin Jubë, Durrës, një shtetas kishte qëlluar me armë zjarri në ajër, shërbimet e Komisariatit të Policisë Durrës, në bashkëpunim me Forcën Operacionale, kanë organizuar punën dhe kanë mbërritur në vendin e njoftuar, me qëllim arrestimin e autorit.

Si rezultat i ndërhyrjes së menjëhershme në kuadër të operacionit policor të koduar "Kalibri", u kap dhe u arrestua shtetasi E. B., 26 vjeç, banues në fshatin Jubë, Durrës.

Shtetasi E. B. ka qëlluar me armë zjarri kallashnikov në ajër, për të kanosur kushëririn e tij, shtetasin M. B., 63 vjeç, me të cilin ishte konfliktuar për motive të dobëta.

Arma e zjarrit kallashnikov që posedohej pa leje nga 26-vjeçari, 2 krehra dhe 54 fishekë luftarak, u gjetën nga Policia dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", "Kanosja" dhe "Prishja e qetësisë publike".

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: arrestohet 26-vjeçari | Durres

TË NGJASHME

Iu merrte para qytetarëve për parkimin në një hapësirë publike, arrestohet 57-vjeçari në Durrës
21 Gusht, 2023

Autor i 8 vjedhjeve dhe 6 tentativave nga qershori në gusht, kapet skifteri i verës në Durrës (Emri)
21 Gusht, 2023

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Shkoi të rrëmbente vajzën që donte, pasi familja nuk pranoi zbrazi kallashnikovin drejt banesës, zbardhen detaje nga ngjarja në Skrapar
Eneida Petova | 22 Gusht, 2023

Mashtroi 200 koreanë dhe përfitoi 28 mln euro, 61-vjeçari gjerman kërkon lirinë kundrejt garancisë pasurore, ja çfarë vendosi gjykata
22 Gusht, 2023

"Çmendet" 34-vjeçari, qëllon me kallashnikov një banesë dhe i rrezikon jetën një familjeje, arrestohet
22 Gusht, 2023

EMRAT/ Goditi me sende të forta një burrë dhe një grua në Delvinë, shpallet në kërkim 32-vjeçari
22 Gusht, 2023

"Veprim i çmendur", BMW me shpejtësi skëterrë hipi mbi digë, eksperti rrugor: Mund të ketë qenë nën efektin e narkotikëve ose...
22 Gusht, 2023

Aksidenti te diga e liqenit në Tiranë/ "Me shpejtësi mbi 250 km/h", gazetari: Shoferi u pa të largohej i lënduar nga vendngjarja
22 Gusht, 2023

KATEGORIA VIDEO

Koncesioni i sterilizimit/ "Asgjë nuk ishtë bërë! pa bekimin e Ramës dhe Beqiajt", Vokshi: Ish-ministri kërkon të kapet pas fijes së kashtës, por...
22 Gusht, 2023

Mashtroi 200 koreanë dhe përfitoi 28 mln euro, 61-vjeçari gjerman kërkon lirinë kundrejt garancisë pasurore, ja çfarë vendosi gjykata
22 Gusht, 2023

"Veprim i çmendur", BMW me shpejtësi skëterrë hipi mbi digë, eksperti rrugor: Mund të ketë qenë nën efektin e narkotikëve ose...
22 Gusht, 2023

Aksidenti te diga e liqenit në Tiranë/ "Me shpejtësi mbi 250 km/h", gazetari: Shoferi u pa të largohej i lënduar nga vendngjarja
22 Gusht, 2023

Gjeste të pahjishme në tribunë, thellohet skandali rreth Rubiales, vjen dhe denoncimi i parë
22 Gusht, 2023

Nga "Ruga e Kosovarëve" fluturon mbi digë, Veliaj publikon videon e aksidentit: Dënimin maksimal për shoferin!
22 Gusht, 2023

LAJMET E FUNDIT

Rama shfaqet në Shpirag me veshje të posaçme para testit përfundimtar për naftën: Përpjekja dhjetëvjeçare po i afrohet orës vendimtare
22 Gusht, 2023

Sudan, Save The Children: Të paktën 500 fëmijë vdesin nga uria në katër muaj luftë
22 Gusht, 2023

Importet e bulmetit po zaptojnë tregun, rritje me 23% në 7-mujor
22 Gusht, 2023

"Të mbrojmë pasurinë natyrore të qarkut të Korçës", prefekti Nertil Jole mbledh Komitetin e Zonave të Mbrojtura
22 Gusht, 2023

Mashtroi 200 koreanë dhe përfitoi 28 mln euro, 61-vjeçari gjerman kërkon lirinë kundrejt garancisë pasurore, ja çfarë vendosi gjykata
22 Gusht, 2023

"Çmendet" 34-vjeçari, qëllon me kallashnikov një banesë dhe i rrezikon jetën një familjeje, arrestohet
22 Gusht, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.